



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br	225/21
Nr. i fq. / Br. st	- 1 -
Data: / Datum	24. 11. 2021
VUSHTRRI - VUČITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA VUSHTRRI

Bazuar në nenin 4 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015 për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, Kryetari i komunës bën këtë:

F T E S Ë

Të nderuar anëtarë/ e të Kuvendit të Komunës

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen inauguroese të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, e cila do të mbahet më datë **06.12.2021 (e hënë) në ora 10:00**. Mbledhja inauguroese do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

Ju njoftojmë se në këtë rast do të bëni betimin dhe do të nënshkruani deklaratën solemne për marrjen e mandatit të anëtarit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

Të bashkëngjitur me ftesë gjeni rendin e ditës dhe deklaratën e betimit solemn.

Ju mirëpresim!

Me respekt!

Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës





REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA VUSHTRRI

Rendi i ditës i propozuar për mbledhjen inauguruese

06.12.2021 ora 10:00

Pjesa e parë – pjesa solemne

10:00-10:15	Arritja dhe nënshkrimi i anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe pjesëmarrësve tjerë.
10:15-10:30	Fjala mirëseardhëse e anëtarit më të vjetër të Kuvendit të Komunës (Kryesues i mbledhjes).
10:30-10:45	Formimi i komisionit për verifikimin e mandateve të anëtarëve të kuvendit të komunës. Verifikimi i mandateve nga komisioni në fjalë.
10:45-11:00	Dhënia e betimit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës. Dhënia e betimit nga Kryetari i Komunës.
11:00-11:15	Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Komunës.
11:15-11:30	Pauzë.

Pjesa e dytë – Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës

11:30-12:15	Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës.
12:15-12:30	Fjala përmbyllëse e mbledhjes nga kryesuesi i zgjedhur i Kuvendit të Komunës.